



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 1/16 DATË 15 / 07 /2021**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT  
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR  
PROJEKTIN E INVESTIMIT “BERYL RESORT” ME SUBJEKTE APLIKUES  
"VORTEK" SH.P.K NIPT K117080040 DHE "BEST DUTY FREE" SH.P.K NIPT  
K01621002N”**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i synuar konsiston në ndërtimin e një Hoteli me 4 Yje plus dhe njësave akomoduese vila e apartamente, së bashku me disa ambiente shërbimi si bare dhe restorante, SPA, akademi sportive kanotazhi, mjedise sportive, çlodhëse dhe rekreacioni në një sipërfaqe prej afërsisht 48,975 m<sup>2</sup> në Fshatin Qerret, ZK. 3101, Bashkia Kavajë.
- Vlera e investimit për këtë projekt parashikohet të jetë 15.519.970 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) persona.
- Dy prej pasurive, pasuria nr. 1/535 dhe pasuria nr. 1/536 në ZK nr. 3101, Bashkia Kavajë, të cilat preken nga ky projekt janë pjesë e fondit pyjor, në pronësi Republika

e Shqipërisë, nën administrim të Bashkisë Kavajë, aktualisht objekt i dy kontratash qiraje ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe subjektit "Vortek" shpk, respektivisht: "Kontratë qiraje ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe subjektit "Vortek" shpk ref ark 0000521 0 dhe "Kontratë qiraje ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe subjektit "Vortek" shpk ref ark 00005210. Ndërkohë pjesa tjetër e sipërfaqes, pra sipërfaqe prej 38,803 m2, figuron sërish pjesë e fondit pyjor, në pronësi Republika e Shqipërisë.

- Pasuritë, që preken nga projekti, përfshihen në tre zona dhe konkretisht: G2-A 12-01 (zonë për përmirësim dhe plotësim); G2-A1 1-01 (zonë vetëm për aktivitete rekreative); N143 (zonë natyrore pyjore).
- Projekti ka aplikuar edhe më parë për marrjen e statusit të investimit/investitorit strategjik dhe KIS me Vendimin Nr. 7/6 datë 15.12.2010 ka vendosur "mospranimin e kërkesës", pasi referuar "Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit" si dhe dokumenteve të tjerë në fuqi për planifikimin dhe rregullimin e territorit, modeli i propozuar i projektit të investimit "Beryl" nuk përputhet me modelin e miratuar në këto akte për një zhvillim cilësor të industrisë së turizmit në përputhje me treguesit që zonat me përparësi zhvillim turizmi (ZPZHT) parashikojnë.
- Subjektet aplikues kanë dorëzuar pranë AIDA-s kërkesë për ri-vlerësim, duke i shtuar dosjes së projektit dokumentacionin si më poshtë:
  - *Memorandum of Understanding for [REDACTED] me brand [REDACTED] është pjesë e grupit [REDACTED];*
  - *Koncept të ri arkitekturor nga studio [REDACTED];*
  - *Kontratë me [REDACTED] e lidhur mes [REDACTED] dhe [REDACTED] për [REDACTED]. [REDACTED] është i përfshirë në projekt dhe i parashikuar si atraksion turistik.*

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

#### **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

## **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Beryl Resort”, me subjekte investues “Vortek” sh.p.k NIUS K11708004O & "Best Duty Free" sh.p.k. NIPT K01621002N”, Fshati Qerret, ZK 3101, Bashkia Kavajë në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Sipërfaqja ku synohet të shtrihet projekti është e llojit “pyll” dhe këto pasuri duhet t’i nënshtrohen procedurës së heqjes nga “fondi pyjor” dhe/ose ndryshimit të kategorisë së përdorimit. Miratimi i këtij projekti kërkon ndryshime përkatëse të parametrave të zhvillimit të zonës, kompetencë e KKT dhe, në këtë këndvështrim, projekti nuk është ende i maturuar.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTËR**

**EDI RAMA**